



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Perandori Justinian 5 - Prishtinë/Pristina
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NË MBROJTJE TË PRONËS PRIVATE – PROTECTING PRIVATE PROPERTY – ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

Notifikimi i kërkesave të paraqitura Agjencisë Kosovare të Pronës

ME RËNDËSI ME RËNDËSI ME RËNDËSI

Nëse besoni se keni ndonjë interes juridik në ndonjë nga pronat e kontestuara të regjistruara në pjesën e bashkangjitur, ju duhet të kontaktoni Agjencinë Kosovare të Pronës sa më shpejt që është e mundur dhe brenda 30 ditëve prej datës së publikimit të kërkesës. Në bazë të nenit 10.1 dhe 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/50, ju keni (a) të drejtën për të marrë pjesë në kërkesë nëse keni interes juridik në pronë. Nëse nuk përgjigjeni brenda afatit 30 ditësh të parashikuar me ligj të përmendur më lartë, KPA-ja dhe KKPK-ja mund të lëshojë urdhër i cili mund të ndikojë në të drejtat tuaja mbi pronën e kontestuar pa ndonjë paralajmërim paraprak..

Nëse tashmë keni pranuar njoftim me shkrim nga KPA-ja se është paraqitur një kërkesë për pronën që ju momentalisht jeni duke e shfrytëzuar, afati i parashikuar me ligj prej 30 ditësh do të fillojë nga dita që ju keni marrë njoftimin e tillë me shkrim.

Çka duhet të bëni nëse besoni se keni të drejtë juridike në njërën nga pronat e kontestuara të cilat janë të regjistruara në pjesën e bashkangjitur?

1. Nëse keni marrë njoftim me shkrim nga KPA-ja se është paraqitur një kërkesë për pronën që tani jeni duke e shfrytëzuar, dhe/apo besoni që ju keni të drejtë juridike pronësore mbi të; dhe ju tashmë keni kontaktuar zyrën e KPA-së me qëllim të pjesëmarrjes në procedurë të kërkesës, nuk kërkohet asnjë veprim nga ju në këtë fazë.
2. Nëse ju besoni se keni të drejtë juridike në njërën nga pronat e kontestuara në listen e bashkangjitur, dhe ju nuk keni marrë njoftim me shkrim nga KPA-ja, ju duhet të kontaktoni njërën nga zyrat e KPA-së brenda 30 ditëve pas publikimit të kërkesës. Në këtë rast, ju keni të drejtën të bëheni palë në kërkesë.
3. Ju lutemi të jeni në dijeni që edhe nëse dikush tjetër ka paraqitur kërkesë për pronën që ju besoni se keni të drejta juridike mbi të, kjo nuk do të thotë domosdo që ata kanë kërkesë valide për pronën. Nëse besoni se ju keni të drejtë juridike në pronën e kontestuar, ju duhet të informoni KPA-në që ju dëshironi të bëheni palë në kërkesë dhe që ju dëshironi të kontestoni kërkesën brenda 30 ditëve pas njoftimit për kërkesën.
4. Duke u bërë palë në kërkesë ju do të njoftoheni rreth përpunimit të më tutjeshëm të kërkesës dhe ju keni të drejtë të prezentoni dhe shqyrtoni informatat dhe dokumentet lidhur me kërkesën bërë KPA-së. Duke u bërë palë, ju do të regjistroni si “palë përgjegjëse” në kërkesë.
5. Me qëllim që ju të kontestoni kërkesën dhe/apo të bëheni palë në kërkesë, ju duhet të dorëzoni në KPA formularin e Njoftimit për Pjesëmarrje jo më vonë se 30 ditë pas publikimit të kërkesës në listën e bashkangjitur. Të gjitha zyret e KPA-së kanë staf kompetent të cilët do t’ju ndihmojnë në plotësimin e këtij formulari.
6. Nëse dëshironi të kontestoni kërkesën, ju duhet të paraqitni në KPA të gjitha dokumentet relevante duke dëshmuar të drejtat tuaja mbi pronën. Këto dokumente mund të përfshijnë:

Kontrata mbi shitjen

Lista poseduese

Vendimi i Gjykatës mbi përcaktimin e të drejtave mbi pronën e patundshme

Deklarata e nënshkruar nga shitësi apo dëshmitari

Kopja e Planit kadastral

Çertifikata kadastrale apo dokumente të tjera kadastrale

Vendimi mbi Ndarjen

Kontrata mbi Shfrytëzim

Kontrata mbi Qiranë

Vendimi mbi trashëgiminë në rast se bartësi i të drejtës pronësore ka vdekur
Faturat e Komunalive
Të dhënat tatimore
Leja e përkohshme e lëshuar nga autoriteti publik apo bartësi i së drejtës pronësore

7. KPA-ja do të hetojë të gjitha informatat e paraqitura nga ju si "palë përgjegjëse" në kërkesë dhe gjithashtu nga personi tjetër i cili ka paraqitur kërkesë për pronën ("paraqitësi i kërkesës"). Kjo përfshinë verifikimin e dokumenteve të paraqitura nga të gjitha palët. Përveç kësaj, KPA-ja mund të bëjë hulumtime në të dhënat publike relevante.
8. Pas hetimit në tërësi të kërkesës për pronë, ajo do t'i prezantohet Komisionit të pavarur Kosovar për Kërkesa Pronësore për vendim.
9. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, KKPK ka jursdiksion të marrë vendim në lidhje me kush ka të drejta juridike në pronë dhe është kompetente të pranojë apo të refuzojë kërkesën që është paraqitur nga "paraqitësi i kërkesës". Nëse nuk pajtoheni me vendimin, atëherë ju keni të drejtë anekse pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. 10. Vendimi përfundimtar i Komisionit të Kërkesave Pronësore, apo në rast të ankesës, vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, janë të detyrueshme dhe të zbatueshme dhe nuk do të shqyrtohen nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.
11. KPA-ja do të implementojë vendimin e marrë nga KKPK-ja, apo në rast të ankesës, nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Ju lutemi kontaktoni ndonjërin nga zyret tona më poshtë nëse besoni se keni të drejtë juridike në ndonjërin nga pronat e kontestuara në listën e bashkangjitur.

Beograd/Belgrade

Kosovska 49/8
Telephone: 011 334 5513
Telefax: 011 334 5314 | 011/334-4452

Gjilan/Gnjilane

Uashington/Rade Popovic
Telephone: 0280 320 289
Telefax: 0280 324 067

Kragujevc/Kragujevac

9, "Lole Ribara" rr
Telefoni: 034 330-234; 330-784
Kati I trete

Kralevë/Kraljevo

Cara Dusana 21
Telephone: 036 234-781

Krushevc/Krusevac

Trg Kosovskih junaka Shtepia e sindikates ,kati 3 IDP Association' Voice of Kosovo and Metohija'
Telephone: 037/443-147

Mitrovicë/Mitrovica

Zyra qendrore:
Shtabi rajonal I UNMIK-ut (ex-Yugobanka)
Telefon: 028 530 136/7
Telefax: 028 530 139
Kancelarija za Posetioce:
Pjesa jugore: Ul. 'Mbretresha Teute' (perballe Yugobankes)
Pjesa veriore: ndertesa e AKM se, dhoma nr.18, UNMIK kompleksi

Pejë/Pec

Zyra qendrore: Ul. Mbreterresha Teute, 153
Telefon: 039 431 668
Telefax: 039 432 970

Nish/Nis

"Dusanov Bazar" (Dusanova)

Telephone: 018 515-727; 515-728
Kati 3, zyra no. 308

Podgoricë/Podgorica

Crnogorskih Serdara
Telephone: 081 624 216 / 081 623-744

Prishtinë/Pristina

Rexhep Luci 2/Goleska 2
Telephone: 038 225 473
Telefax: 038 244 854

Prizren

Zyra kryesore:
Shtabi rajonal I UNMIK-ut
Tel/Fax: (029) 631-469
Tel: (038) 504604 ext. 8046/8024
Zyra e vizitoreve:
Jeronim De Rada"/ "Zef Llush Marku" nr. 63
Tel: (029) 631-429

Shkup/ Skopje

Vinichka Street No. 10 (CDRIM-building), first floor
Telephone: +389 71 886 564

Ju lutem ta keni parasysh qe emrat ne liste jane ne gjuhen e paraqitesit te kerkeses..